



**ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË  
BORDI**

**VENDIM**

***Nr. 129, Datë 16.08.2017***

**MBI**

**FILLIMIN E PROCEDURËS PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË “ENERGY TO ENERGY”SH.P.K., NË AKTIVITETIN E TREGTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE.**

Në mbështetje të neneve 16; 37 pika 2 gërma “d” të Ligjit nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, neneve 4, pika 1, gërma “e”; 5, pika 1 gërma “e”; 10, pikat 1 dhe 3 të “Rregullores për Procedurat dhe Afatet për Dhënie, Modifikimin, Transferimin, Rinovimin ose Heqjen e Licencave në Sektorin e Energjisë Elektrike”, të miratuar me Vendimin e Bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.06.2016 dhe nenit 19 pika 1 gërma “a” e “Rregullave për Organizimin, Funksonimin dhe Procedurat e ERE-s”, miratuar me Vendimin e Bordit të ERE nr. 96, datë 17.06.2016; Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (E.R.E), në mbledhjen e tij të datës 16.08.2017, mbasi shqyrtoi relacionin për fillimin e procedurës për shqyrtimin e aplikimit të shoqërisë “Energy To Energy”sh.p.k.,për licencim në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut;

**Konstatohet se:**

- Shoqëria “Energy To Energy” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 530 Prot., datë 25.07.2017, ka paraqitur kërkesën për t’u pajisur me licencë në aktivitetin e Tregtimit të Energjisë Elektrike.
- Në vijim ky subjekt me shkresën e datës 02.08.2017, protokolluar në ERE me nr. 530/1, datë 02.08.2017, ka përcjellë plotësimin e dokumentacionit në lidhje me aplikimin për licencim në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike.
- Aplikimi i shoqërisë “Energy To Energy” sh.p.k., plotëson kërkesat e parashikuara nga ERE në “Rregulloren për procedurat dhe afatet për dhënie, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licensave në sektorin e energjisë elektrike” si më poshtë:
  - Formati i aplikimit (neni 9, pika 1 gërmat “a”, “b”, “c”), është plotësuar në mënyrë korrekte.
  - Dokumentacionin juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2 gërmat (“a”, “b”, “c”, “d” dhe “e”), është plotësuar në mënyrë korrekte.

- Dokumentacionin financiar dhe fiskal, (neni 9, pika 3, gërmat “a”, “b”, “c” dhe “d”), është plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni tekniko - ekonomik (neni 9, pika 4.8, gërmat “a”, “b”, “c” dhe “d”), është plotësuar në mënyrë korrekte.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE,

**Vendosi:**

1. Të fillojë procedurën për licencimin e Shoqërisë “Energy To Energy” sh.p.k., në aktivitetin e Tregimit të Energjisë Elektrike.
2. Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut, të njoftojë aplikuesin për Vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.